

Mbi 150 ankesa të dorëzuara rreth transparencës së institucioneve për vitin 2018, komisioni përgjegjës pa kuorum që në muajin maj

Viti 2018, rezulton si viti me më pak ankesa për mostransparencë institucionale, krahasuar me të dhënat e raporteve të Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik të përpiluara për vitet 2015,2016,2017.

Konkretisht, deri në fillim të muajit shtator, numri i ankesave të dorëzuara ishte mbi 150, ndërsa në vitet 2015,2016 dhe 2017 numri i ankesave ishte më i lartë, respektivisht 960, 619 dhe 758.

Në shikim të parë të dhënat për vitin 2018 duken premtuese rreth transparencës së institucioneve, pavarësisht se nuk janë përfundimtare. Duhet pasur parasysh se komisioni ku dorëzohen ankesat rreth 2/3 e vitit nuk kishte dhe vazhdon të mos ketë kuorum për të mbajtur mbledhje. Parë nga ky këndvështrim, numri i ulët i ankesave të dorëzuara nuk është domosdoshmërisht tregues se gjatë këtij viti kemi pasur institucione me transparente se më parë.

Ministria përgjegjëse për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë, i referohet një hulumtimi ndërkombëtarë të mbështetur nga Bashkimi Evropian, sipas të cilit Maqedonia për vitin 2018 radhitet si më transparentja në rajon.

"Qeveria e Republikës së Maqedonisë është në vendin e parë në rajon sa i takon transparencës. Këtë e tregon hulumtimi ndërkombëtarë "Action see", mbështetur nga Bashkimi Evropian, ku matet indeksi i transparencës së institucioneve në Maqedoni, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Serbi dhe Mal të zi. Në të njëjtin hulumtim, gjatë vitit të kaluar, Maqedonia ishte në fund të listës, konkretisht në vendin e 6-të. Përparim i madh është vërejtur edhe tek ministritë të cilat nga vendi i fundit në hulumtimin e vitit të kaluar, tani gjenden në vendin e tretë, pas Malit të zi dhe Serbisë"- thuhet në përgjigjen e Ministrisë përgjegjëse për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë.

Duke bërë një krahasim të raporteve të publikuara nga viti 2015 të Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik, fitohet një pasqyrë më e qartë se si ka lëvizur niveli i transparencës institucionale.

Në vitin 2015, kur në pushtet ishte VMRO-DPMNE dhe BDI, ankesat më të shumta ishin për ministritë si: ajo për Transport dhe Lidhje, Arsim dhe Shkencë, Vetëqeverisje lokale, e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, ajo për Punë dhe Politikë Sociale, Ministria e Drejtësisë, për Komisionin kundër korrupsionit dhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, si dhe për disa ndërmarrje publike.

Në vitin 2017, kur tashmë vendi kishte një qeveri të re, e cila premtojte se institucionet shtetërore do të ishin më transparente gjatë qeverisjes së saj, numri i ankesave të dorëzuara ishte 758. Pra, vetëm 202 ankesa më pak se në vitin 2015 kur në pushtet ishte VMRO-DPMNE dhe BDI, dhe 139 ankesa me shumë

se në vitin 2016, kur gjithashtu në pushtet ishte qeveria e kaluar.

Vitet me numrin më të lartë të ankesave mund të kuptohen si ndërgjegjësimin më i madh i qytetarëve rreth të drejtës së tyre për tu informuar, por në të njëjtën mund të shihen si tregues të një transparence më të ulët të institucioneve.

Shpjegimi që ministria përgjegjëse jep për këto shifra është se vendosja në dispozicion e informacioneve për të gjithë qytetarët, ka vërshuar institucionet publike me kërkesa për qasje të lirë dhe në një situatë të tillë të njëjtat nuk kanë pasur personel të mjaftueshëm. Rrjedhimisht nuk kanë arritur t'u përgjigjen në kohë të gjitha kërkesave.

"Rritja e numrit të ankesave të dorëzuara deri tek Komisioni për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik për vitin 2017 vjen për shkak të vendimit të Qeverisë në lidhje me rritjen e transparencës dhe t'i bëjë të qasshme për qytetarët të gjitha informacionet, përveç atyre që kanë të bëjnë me sigurinë. Institucionet janë përballur me një numër shumë të lartë të kërkesave për qasje të lirë, sepse pas një dekade mbyllje dhe mostransparencë dhe pamundësi qasje deri tek institucionet, më në fund informacionet ishin në dispozicion të të gjithë qytetarëve. Përgjigjet e vonuara të kërkesave të shumta për qasje të lirë kanë ndodhur si pasoje e kufizimeve tek resurset njerëzore dhe jo nga jotransparenca e institucioneve"- thonë nga Kabineti i ministrit pa resor për gjegjës për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie, Robert Popovski.

Në 2017 institucionet e cilësuara si më jo transparente janë: Komunitat e Republikës së Maqedonisë dhe qyteti i Shkupit, Ministria e Shëndetësisë, shtëpitë e shëndetit, Ndërmarrjet publike, qendrat ndërkomunale për punë sociale, Ministria e ekonomisë, Ministria e financave, komisioni rregullator për energjetikë e të tjera.

Ministria e Financave është emri i institucionit që figuron si jo transparent në të tre raportet, pra për vitin 2015, 2016, 2017.

Gjatë vitit 2017, sipas raportit të Komisionit për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik, institucionet më së shumti nuk kanë dhënë informacione për prokurimet publike, konkurset për zgjedhje dhe emërimet, listë të informacioneve për investimet e huaja, numrin e aplikuesve dhe fituesve të programeve IPARD , rrogat neto të funksionarëve shtetërorë dhe anëtarëve të këshillave, shumat e paguara për shpenzime rrugore për personat drejtues dhe anëtarë të komisioneve, të dhëna për paga dhe tarifa të paguara për punonjësit e Prokurorisë Publike për ndjekjen e veprave penale që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e paligjshme e ndjekjes së komunikimeve e të tjera.

Nga kabineti i ministrit Popovski, këtyre të dhënave u vendosin përballë këto përgjigje:

" Në vitin 2017 për herë të parë filluan të bëheshin publike marrëveshjet për prokurime publike në sistemin "e-nabavki".Institucionet u obliguan që përveç prokurimeve publike të publikojnë edhe

dokumentacionin e plotë për lidhjen e marrëveshjeve, duke përfshirë edhe kyçje që kanë implikime financiare"

"Sa u takon konkurseve për zgjedhje dhe emërimë, duke pasur parasysh se viti 2017 ishte vit i zgjedhjeve, më 31 maj të viti 2017 u formua qeveria e re dhe u mbajtën edhe zgjedhjet lokale, në momentin e shpalljes së zgjedhjeve pati kufizim të shpalljes së konkurseve për punësime. Në periudhën para dhe pas zgjedhjeve lokale të gjitha konkurset janë publikuar në përputhje ligjet thelbësorë për funksione të ndara. Në korniza të kompetencave të gjitha aktet e sjella për zgjedhje dhe emërimë, janë publikuar në Gazetën Zyrtare".

"Lista e informacioneve për investimet e huaja në përputhje me ligjin për mbështetje financiare do të publikohet kur të ketë përfunduar i gjithë procesi i pagimit të kompanive të cilat kanë marrëveshje valide, Kjo parashikohet që të bëhet deri në fund të këtij viti

Nga kjo ministri edhe më tej thonë se institucionet kanë qenë transparente edhe për pikat e tjera të sipër përmendura.

Madje shtojnë se për të rritur transparencën, në faqen zyrtare të Qeverisë janë publikuar rrogat e Kryeministrit, ministrave dhe sekretarit të përgjithshëm të qeverisë.

Ndërkohë, për të pasur më shumë detaje rreth vitit aktual kërkua qendrim zyrtarë nga Komisioni për mbrojtje të qasjes së lirë deri tek informacionet me karakter publik.

Nga ky komision na thanë se informacione të tilla nuk mund të japin, pasi që më saktësisht të njëjtat përpunohen pasi shqyrtohen në seancat e komisionit, cili që në muajin maj nuk ka kuorum, pra është i bllokuar.

Ky fakt, sipas disa gazetarëve, ka ndikuar pjesërisht që të njëjtët të mos dorëzojnë ankesa edhe atëherë kur kanë pasur të tilla rreth institucioneve të caktuara, kur këto të fundit nuk janë përgjigjur në kohë ose aspak dhe nuk kanë dhënë informacionet e kërkuara.

Vasko Magleshov, MakFax

"Po. Me siguri deri tani kemi më shumë se pesë ankesa të dorëzuara deri tek Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik"

Goran Momiroski, Alfa Tv

"Jo, nuk kam derguar".

Tamara Çausidis, BIRN

"Kemi dërguar deri sa Komisioni funksiononte. Por tani nuk i shqyrton dot, sepse nuk ka kuorum. Megjithatë shërbimet përpiqen të ndihmojnë edhe në situata të tilla"

Ismail Sinani, Tv Shenja.

"Jo, nuk kemi dërguar. Por vazhdimisht në mënyrë publike u kemi bërë apel zyrtarëve të BDI-së që të kenë qasje transparente".

Sipas tyre, disa nga institucionet më problematike gjatë vitit 2018 kanë qenë:

Vasko Magleshov, MAKFAX

" Unë do të përmendja Prokurorinë Publike, Avokatin e Popullit, por ka edhe të tjera."

Goran Momiroski, Alfa Tv

"Do të përmendja Ministrinë e Punëve të Jashtme"

Tamara Çausidis, BIRN

" Nga eksperiencia e them, Ndërmarrjet publike e marrin më ngadale procesin për t'u përgjigjur. Do të përmend si shëmbull Radio Televizionin e Maqedonisë.

Ismail Sinani, Tv Shenja

" Problemin e transparencës e kemi hasur me Bashkimin Demokratik për Integrim dhe institucionet që drejtohen nga përfaqësuesit e kësaj partie. Pra problemi ekziston vetëm tek kjo parti politike"

Ankesat nuk kanë të bëjnë vetëm me mos dhënien e informacionit. Shpeshherë përgjigjet janë klishe dhe sipërfaqësore.

Vasko Magleshov-MAKFAX

" Nuk përgjigjen gjithmonë në kohë. Kur bëhet fjalë për përgjigje të thjeshta, përgjigjen në kohë, por ndonjëherë citojnë ligje, duke mos u përgjigjur konkretisht për pyetjen. Për shembull, kërkova të dhëna nga Agjencioni për Komunikime Elektronike për atë se sa para harxhohen për rroga dhe tarifatat dhe më dërguan citim të ligjit për AKE. Në përgjigje thuhej se ato janë të dhëna që AKE është e detyruar të ia dorëzojë Kuvendit."

Goran Momiroski- Alfa TV

“Zakonisht përgjigjen, por jo gjithmonë shpejt dhe plotësisht. Shpeshherë i shmangen përgjigjes direkte. Për shembull, më 30 shtator e pyeta Zoran Zaevin se a do të japë dorëheqje, ashtu si premtoi, nëse referendumi nuk do të jetë i suksesshëm dhe ai tha se referendumi ishte i suksesshëm.”

Tamara Çausidis-BIRN

“Ka institucione të cilat përgjigjen relativisht në kohë në përputhje me afatin. Si shembull do të merrja së fundmi Ministrinë e Kulturës, Qytetin e Shkupit, Qeverinë. Institucionet përgjigjen në kohë, sepse kërkesa parashtrohet më dokumentin adekuat. Nëse parashtrohet pyetje që nënkupton mendim, apo qëndrim politik, atëherë nuk ka të bëjë me informacion të karakterit publik.

Ismail Sinani- TV SHENJA

“Nëse deri para disa vitesh institucionet lëshonin komunikata apo njoftime, me avancimin e teknikave të PR-it, të njëjtat tani më përgatisin lajme me tekst, video dhe fotografi, të cilat ua dërgojnë mediave. Pra në shikim të parë, kjo duket si transparencë, por në thelb kjo më shumë i ngjanë një kahëzimi të fuqishëm që institucionet ua bëjnë mediave. Medoemos duhet theksuar se prej katër vitesh, institucionet që drejtohen nga Bashkimi Demokratik për Integrim, qoftë në koalicionin qeverisës me VMRO DPMNE-në, qoftë tani me LSDM-në, janë të mbyllura. Kuptohet ndonjëherë ekziston edhe ndonjë përjashtim i vogël.”

Afati 30 ditorë që ligji (neni 21 Ligji për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik) u ka vënë në dispozicion institucioneve për t’u përgjigjur, sipas redaktorëve dhe gazetarëve është shumë i gjatë. Ata thonë se ky nen duhet ndryshuar, pra të jetë jo më shumë se 10 ditë.

Vasko Magleshov-MAKFAX

“Absolutisht afati duhet të jetë më i shkurtër, jo më shumë se 10 ditë”

Goran Momiroski- Alfa TV

“Sigurisht, afati nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë”

Tamara Çausidis-BIRN

“Po. Konsideroj se afati duhet të jetë më i shkurtër se 30 ditë”

Ismail Sinani- TV SHENJA

“Gjithsesi se mund dhe duhet të jetë më i shkurtër, por duhet parë edhe praktikata në vendet e Bashkimit Evropian.”

Këto ishin disa nga të dhënat që mundëm të mbledhim për vitin 2018, në mungesë të të dhënave zyrtare apo të raportit final të Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik.

Sa i takon komisionit të lartpërmendur i njëjti tashmë ka vetëm një anëtarë dhe kryetarin. Pas dorëheqjes më 2 maj të vitit 2018 të kryetarit Gjorgji Sllamkov, në përbërje të këtij komisioni janë vetëm Blerim Hyseni dhe Valentina Fidanovska.

Këtë gjendje na e shpjegoi më mirë kryetari i zgjedhur së fundmi i këtij komisioni.

Blerim Hyseni- kryetarë në Komisionin për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik.

“Mbledhja e fundit e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik, është mbajtur më 16 Prill dhe që atëherë nuk ka pasur kuorum për mbajtje të mbledhjes dhe shqyrtimin e ankesave, ndërsa parlamenti ka konstatuar dorëheqjen e kryetarit me 2 maj të këtij viti. Ndryshe dy anëtarë të Komisionit nuk kanë qenë të emëruar një kohë të gjatë (por komisioni ka funksionuar me kryetar, zëvendëskryetar dhe një anëtarë) me shumicë të thjeshtë dhe ka pasur të drejte ligjore të vendos për lëndët.”

Për t’u informuar se kur pritet që Kuvendi të plotësojë vendet vakante, për të cilët emrat propozohen nga Qeveria dhe më pas i dorëzohen organit ligjvënës, tentuam të kontaktojmë me kryetarin e Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve. Si për ironi, edhe pse ky tekst i dedikohet transparencës institucionale, deputeti i VMRO-DPMNE-së, Ilija Dimovski, njëherësh edhe kryetar i këtij komisioni, për disa javë i kishte në dispozicion pyetjet, por të njëjtave nuk denjoi t’u përgjigjet, as me shkrim dhe as gojarisht.

Shërbimet e Kuvendit të Maqedonisë na informuan se seanca e komisionit u mbajt më datë 18.10.2018, por se aty u vendos vetëm për emërimin e kryetarit, por jo edhe për anëtarët. Blerim Hyseni nga posti zëvendëskryetar, u emërua kryetarë i Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik. Megjithatë, kjo nuk e zgjidh problemin e krijuar, sepse komisioni tashmë ka kryetar, por vazhdon të mos ketë kuorum. Ndërkohë që dy anëtarë të këtij komisioni nuk janë emëruar asnjëherë.

Përgatiti: Evi Shkopi

